



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:107854

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05876211

KPPP.nr.1756/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbarimore të kreditorit SE-FA Hurriyet Mh.Menekse 2 Cd nr.44 Istanbul, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Liman Musa me seli të zyrës në Ferizaj, kundër debitorit The North Unicorn LLC, zyra qëndrore Zona Industriale Aziz Abrash pn, në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë avokatët Arianit Koci dhe Granit Vokshi, me seli të zyrës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr.231/2022 të datës 21.04.2022, nga Përmbaruesi Privat Besnik Aliu me seli në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 24.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit The North Unicorn LLC., ANULOHET Urdhri Përmbarimor P.nr.231/2022 i datës 21.04.2022, i Përmbaruesit Privat Besnik Aliu, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.
- II. Detyrohet kreditori që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi t'ia paguaj debitorit shpenzimet e procedurës në këtë gjykatë në shumë të përgjithshme prej 78.00 Euro, në emër të përpilimit të prapësimit nga avokati.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit nga i autorizuari i kreditorit SE-FA Hurriyet Mh.Menekse 2 Cd nr.44 Istanbul, me datë 21.04.2022, ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.231/2022, me të cilin e ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës së datës 22.10.2020, si dhe CMR nr.2604 të datës 28.10.2020 dhe CMR.nr.2611 të datës 28.10.2020, që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri, t'i paguaj kreditorit shumën prej 450.00 €, me kamatë ligjore prej 8%, nga data e lëshimit të faturës e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrin të Përmbaruesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me arsyetimin se propozimin për përmbarim e karakterizon parregullësia në përmbajtjen e tij, për faktin se propozimi për përmbarim mbështetet në faturë gjuhën e së cilës debitori nuk e kupton, pra fatura në fjalë nuk është në asnjërin nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. Më tutje ka theksuar se fatura në fjalë është e panëshkruar dhe e pavulusur, dhe e njejta do të përbënte precedent tejet të rrezikshëm nëse ekzekutohet në procedurë përmbarimore. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si i themeltë prapësimi i debitorit, dhe të shfuqizohet urdhri përmbarimor P.nr.231/2022 i nxjerrë nga Përmbaruesi Privat, si dhe të obligohet kreditori që t'i paguaj shpenzimet për përpilimin e prapësimit në vlerë prej 104.00 Euro. sipas Tarifës së Odës së Avokatëve.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, për arsye se asnjë nga thëniet e tij në prapësim nuk qëndrojnë, ngase i njejti nuk ka arritur që me asnjë provë materiale t'i vërtetoj pretendimet e tij. Më tutje ka theksuar se përkundër që iu kemi drejtuar debitorit që të bëjë pagesat e faturave, i njejti nuk i kontestuar asnjëherë obligimet, mirëpo ka kërkuar vazhdimisht kohë për ta kryer këtë pagesë, dhe pasi nuk kemi hasur në mirëkuptim jemi detyruar që të fillojmë procedurën ligjore të përmbarimit. Ka shtuar se nuk ekziston asnjëri nga kushtet për anulimin e urdhrin për përmbarim, pasi që i njejti është nxjerrë konform LPP-së, ngase faturat i plotësojnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm. I ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzojë si të pabazuar, ndërsa ta vërtetojë urdhrin përmbarimor, dhe nëse debitori ushtron ankesë ndaj aktvendimit të gjykatës të obligohet të deponoj shumën në lartësi të borxhit, në emër të garancisë

për ankesë. I ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumën prej 208 Euro sipas TOAK-së, numri tarifor 9 lidhur me numrin tarifor 6.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29, par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nenin 29 par.3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Fatura e datës 22.10.2020, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që fatura është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se fatura është dorëzuar te debitori pasi që e njëjta nuk është nënshkruar ose vulosur nga ana e debitorit dhe si e tillë nuk është e përshtatshme për përmbarim.

Duke qenë se debitori nuk ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën e lartcekur, si e tillë nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, përderisa njëra palë procedurale - debitori nuk ka pranuar një detyrim që rrjedh nga fatura.

Gjykata po ashtu vlerësoi edhe CMR nr.2604 të datës 28.10.2020 si dhe CMR.nr.2611 të datës 28.10.2020, si dokumente ndërkombëtare për mënyrën e transportit të mallrave, të cilat janë të nënshkruara dhe vulosura nga debitori, mirëpo gjeti se dokumentet mbi transportimin e mallrave (CMR) paraqesin dëshmi në raport ekzistimin e kontratës mbi transportimin e mallrave mes dërguesit dhe transportuesit, këtu kreditorit, mirëpo jo dëshmi përmes së cilës mund të

arrihet në përfundim se këtu debitori ka pranuar faturën mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri apo se është pajtuar si për nga përmbajtja ashtu edhe lartësia e detyrimit monetar që buron nga fatura. Në këtë drejtim, gjykata rikujton se procedura përbarimore i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përjashtimisht vlerësimi të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përbarimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21 dhe 29 të LPP-së.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përbarim, e mbi bazën e të cilit Përbaruesi privat ka lejuar përbarimin, nuk ka tipare të përbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e Përbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundojë në tërësi.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përbarimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet e të autorizuarit të debitorit për përpilimin e prapësimi dhe atë në shumën prej 78.00 Euro, siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifën e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi..

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1756/23, datë 24.06.2024

Gjyqtari
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.